

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 Për Fondet Pensionale në Kosovë me ndryshim plotësimet e mëtutjeshme të këtij Ligji. FKPK-ja, në përputhje me nenin 8 dhe 16 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 rishpall:

KONKURS PËR PUNË PRAKTIKE

për plotësimin e pozitës me të dhënat si në vijim:

Titulli i pozitës: PRAKTIKANT NË DEPARTAMENTIN E SHËRBIMIT PËR KLIENTË (1 POZITË)

Orët e punës: 40 orë në javë

Numri i referencës: R-KON042026

Kohëzgjatja e emërimit: 6 (gjashtë) muaj me mundësi vazhdimi në 1 (një) vit

Adresa: Rr. "Perandori Justinian" Nr. 71, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranimi dhe koordinimi i thirrjeve telefonike.
- Pritja e vizitorëve në zyrë dhe orientimi i tyre te këshilltarët tjerë për klientë.
- Asistimi në identifikimin, vlerësimin dhe zgjidhjen e kërkesave të klientëve.
- Sigurimi i një sjelljeje profesionale dhe të sjellshme ndaj klientëve të FKPK-së.
- Përdorimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të zyrës, si kompjuteri, telefoni, fotokopjuesi dhe skaneri.
- Administrimi i dokumenteve dhe dërgesave, përfshirë protokollimin, arkivimin, radhitjen dhe shpërndarjen e tyre.
- Menaxhimi i inventarit të zyrës, duke përfshirë mbajtjen e shënimeve dhe realizimin e kërkesave për furnizim.
- Respektimi i orarit të punës me përpikëri.

Kriteret e konkursit:

Përvoja: Nuk aplikohet

Edukimi: Diplomë universitare (së paku baçelor të fituar nga viti 2023 e tutje)
(ose studentët e vitit të fundit të studimeve)

Nota mesatare: Së paku 7.5

Gjuha: Njohuri e shkëlqyer e gjuhës shqipe
Njohuria e gjuhëve serbe dhe angleze është përparësi

Aftësitë: Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi
Njohuri e avancuar e MS Office (sidomos Word dhe Excel)
Aftësi të prioritizimit të punëve në situata presioni

Shënim i rëndësishëm: Të mos ketë qenë i/e angazhuar më parë në programet e praktikës në FKPK.

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

Konkursi është i hapur deri më **15 qershor 2026 23:59 (CET)**, Puna praktike është me pagesë.

Konkurrimi bëhet vetëm përmes postës elektronike (e-mail) në: recruitment@trusti.org, duke vendosur si titull "Konkursi për praktikantë 2026", duke bashkëngjitur dokumentet në vijim (në formatin PDF):

1) Jetëshkrimin (CV-në); **2)** Letrën motivuese; **3)** Diplomën (e skanuar) e kualifikimit më të lartë arsimor. (Kandidatët që janë në vitin e fundit të studimeve, paraqesin certifikatën e notave të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë).

VËMENDJE!

1) Kandidatët mund t'i nënshtrohen një testi preliminar. Pas testit mund të përzgjidhen kandidatët për intervistë. Vetëm kandidatët e zgjedhur për intervistë do të njoftohen pas testimit.

2) Aplikacionet pa bashkëngjitur "Dokumentet për aplikim" (pikat e obligueshme 1 deri 3) si dhe ato të dorëzuara pas afatit, NUK do të shqyrtohen. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit do të kontaktohen.